



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. <u>01-2899/15</u>
Dep. <u>02</u>	B: Prot. <u>01-2899/15</u>
Nr. l faq. <u>02</u>	Data <u>25-09-2015</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>25-09-2015</u>
Nr. pages <u>02</u>	Data <u>25-09-2015</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.09.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2497/15, për z. Hajdar Beqa, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, duke u larguar nga personi i autorizuar në biznesin privat.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2497/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Hajdar Beqa, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë z. Hajdar Beqa, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë është i angazhuar në veprimtari private si person i autorizuar në një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 20.08.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Hajdar Beqa, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është pajtuar me gjendjen, dhe është zotuar se brenda afatit ligjor do ta bëj ndryshimin e kërkuar nga AKK, dhe do të largohet nga pozita e personit të autorizuar në këtë biznes .

Me datën 17.09.2015, nga z. Hajdar Beqa kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet z. Hajdar Beqa, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin D.P.H “Galeri Cafe”- 70372343.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Hajdar Beqa, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dukë bërë ndryshimet sipas kërkesës së AKK-së, ne biznesin ku ka vepruar si person i autorizuar, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Hajdar Beqa, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

